



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +383 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-p.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/426  
Datë: 25/7/2024

Senati i Universitetit të Prishtinës, në kuadër të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 173, paragrafi 4 të Statutit të UP-së, në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-037 për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, Rregulloren me nr. 2/254, datë 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime, në Universitetin e Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur me datën 12.7.2024, vendosi të shpallë:

**THIRRJE PUBLIKE**

**Për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njësive akademike të Universitetit të Prishtinës për vitin akademik 2024/25.**

Angazhimi me honorar i bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime do të bëhet sipas propozimit të njësive akademike, në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë, dispozitat e Statutit të Universitetit të Prishtinës, Rregulloren me nr. 2/254, datë 17.07.2024 për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime në UP, Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim si dhe standardet e miratuara nga AKA-ja dhe Rregulloren në fuqi për të ardhurat personale të personelit akademik të UP-së.

**I. Procedura e angazhimit sipas konkursit dhe përjashtimet për kategoritë e caktuara**

Procedura e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime nëpërmjet shpalljes së **THIRRJES PUBLIKE**, bazuar në Rregulloren me nr. 2/254, datë 17.07.2024 për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm.

**II. Kushtet e angazhimit**

1. Personat e angazhuar në cilesinë e bashkëpunëtorëve të jashtëm nuk marrin thirrje akademike. Angazhimi i tyre bëhet bazuar në procedurat specifike të përcaktuara në Rregulloren me nr. prot. 2/254, datë 17.7.2024 për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP.
2. Me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit dhe nepotizmit në Universitet të Prishtinës, nuk mund të angazhohen kandidatët që kanë të punësuar apo të angazhuar në njësinë akademike përkatëse, persona në marrëdhënie familjare (në relacionin prind-fëmijë, vëlla-motër, motër-motër, vëlla-vëlla dhe anasjelltas).
3. Për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ligjërata kandidatët duhet ti plotësojnë këto kushte:
  - Të ketë të paktën gradën shkencore Master i shkencave/arteve<sup>1</sup>, ndërsa kandidatët me gradën Doktor i shkencave, nga lëmia përkatëse (në Fakultetin e Arteve ekuivalente me të), kanë përparësi.
  - Të ketë së paku 1 publikim në revistat shkencore ndërkombëtare (në Fakultetin e Arteve së paku 1 vepër artistike të rangut ndërkombëtar në fushën

<sup>1</sup> Kandidati me gradën shkencore Master duhet të ketë notën mesatare jo më të vogël se 8 në të dy nivelet e studimit.

përkatëse). Për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ligjërata në Mjekësi, në lëndët klinike, kandidati duhet të jete specialist i fushës përkatëse.

4. Për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ushtrime kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:
  - Të kenë të përfunduar studimet master ose ekuivalent me të në fushën përkatëse.
  - Të ketë notën mesatare jo më të vogël se 8 në të dy nivelet e studimit.
  - Në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinës (në lëndët klinike të veterinarisë) dhe në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (në lëndët laboratorike<sup>2</sup>) kandidati duhet të dëshmojë që ka së paku 3 vite përvojë pune profesionale në fushën përkatëse.
  - Në Fakultetin e Mjekësisë (në lëndët klinike), të ketë të përfunduar specializimin ose të jetë së paku në vitin e tretë të specializimit në fushën përkatëse. Angazhimi behet duke marre parasysht edhe Ligjin e Shëndetësisë.
  - Në Fakultetin Ekonomik, për ushtrimet në lëndet e kontabilitetit dhe auditimit, kandidati duhet të jetë kontabilist, përkatësisht auditor i certifikuar sipas legjislacionit në fuqi dhe të ketë së paku 3 vite përvojë pune profesionale në fushën përkatëse.
5. Bazuar në Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, vlerësimi dhe propozimi i kandidatëve për emërim bëhet nga Komisioni vlerësues.

### **III. Fondi i orëve për bashkëpunëtorët e jashtëm**

1. Bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata dhe profesorët vizitorë mund të mbajnë deri në 6 orë në javë.
2. Bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime mund të mbajnë deri në 10 orë në javë.

### **IV. Periudha e angazhimit dhe kompensimi**

1. Angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm bëhet për një semestër përkatësisht për dy semestra të të njëjtit vit akademik, ndërsa kontrata lidhet për vitin akademik përkatës.
2. Pas vlerësimit pozitiv për bashkëpunëtorin/en, me propozim të dekanit, angazhimi mund të vazhdohet edhe për 1 vit akademik, e jo më shumë se dy vite tjera (4 semestra), pa shpallur thirrje publike. Propozimi i arsyetuar i dekanit duhet të miratohet në Senat.
3. Kompensimi për angazhim bëhet në bazë të orëve të realizuara, respektivisht për semestrin/at për të cilët angazhohet për mbajtjen e ligjëratave/ushtrimeve, sipas kohëzgjatjes së semestrit të bazuar në Statutin e UP-së.
4. Vlera e kompensimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm është e përcaktuar në Rregulloren për të ardhura personale të personelit akademik, e cila është në fuqi në momentin e nënshkrimit të kontratës.
5. I angazhuari ka për obligim që në kuadër të kontratës të mbajë provirmet për të gjitha afatet brenda vitit përkatës akademik.
6. I angazhuari, nëse ka titullin Dr. Sc. ose ekuivalente me të në Fakultetin e Arteve, ka të drejtë të mentorojë kandidatët në nivelin Bachelor.
7. I angazhuari mund të jetë anëtar i komisionit për mbrojtjen e temave në nivelin bachelor dhe master.

---

<sup>2</sup> Lista e lëndëve klinike të Fakultetit të Mjekësisë, lëndëve klinike të fushës së veterinarisë, lëndëve laboratorike të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike dhe lëndët e kontabilitetit dhe auditimit në Fakultetin Ekonomik është e publikuar në web faqen e Universitetit të Prishtinës dhe të fakulteteve përkatëse.

## **V. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim**

Kandidatët që aplikojnë për bashkëpunëtor të jashtëm duhet ti paraqesin këto dokumente:

- a) Kërkesën për aplikim;
- b) Biografinë (CV);
- c) Çertifikatën/ekstraktin e lindjes;
- d) Kopjen e diplomës përkatëse të vërtetuar me vulë origjinale nga noteri, për pozitën që aplikon;
- e) Kandidatët që i kanë mbaruar studimet jashtë vendit me rastin e aplikimit për angazhim duhet të ngarkojnë vendimin për nostrifikim (barasvlerë) të diplomës përkatëse (bachelor, master, magjistraturë, doktoratë).
- f) Kandidatët, të cilët konkurojnë për pozitën e bashkëpunëtorit për ushtrime, lektorit dhe korepetitorit duhet të sjellin edhe çertifikatën origjinale të notave të studimeve bachelor dhe atyre master, ose kopjen e noterizuar me vulë origjinale nga noteri;
- g) Dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale;
- h) Dëshmitë eventuale për angazhimet paraprake në UP ose në ndonjë Institucion të akredituar të arsimit të lartë .
- i) Dëshmi të lëshuar nga Gjykata kompetente, përmes së cilës dëshmohet që kandidati nuk është i dënuar.
- j) Dëshmi tjera relevante për pozitën në të cilën aplikon.

## **VI. Komisioni vlerësues dhe e drejta e ankesës**

1. Për formimin e komisionit vlerësues dhe procedurat e implementimit vlejné dispozitat e Rregullores me nr. 2/254, datë 17.07.2024
2. E drejta e ankesës dhe afatet e ankesës janë të përcaktuara me dispozitat e Rregullores me nr. 2/254, datë 17.07.2024.
3. Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë ankese pranë komisionit për ankesa në fakultetin përkatës, brenda 5 ditëve nga publikimi i raportit të Komisionit vlerësues në web-faqe.
4. Vendimi i këshillit të fakultetit, me listën e kandidatëve të pranuar si bashkëpunëtorë të jashtëm, dërgohet në Senat për informim.

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në versionin elektronik brenda afatit të thirrjes publike, në modulën përkatës të sistemit të Universitetit të Prishtinës, në linkun në vijim: <https://stafiakademik.uni-pr.edu>.

Aplikacionet e arritura pas afatit, ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

**Thirrja publike** publikohet në faqën zyrtare të UP-së <https://www.uni-pr.edu>, dhe në web-faqet e njësive akademike, duke filluar nga data 25 korrik 2024 **ndërsa aplikimi do të jetë i hapur nga data 15 gusht deri me 22 gusht 2024, në kohëzgjatje prej 8 (tetë) ditësh kalendarike.**

**Thirrja publike shpallet sipas propozimeve të njësive akademike dhe atë si në vijim:**

## I. FAKULTETI FILOZOFIK

1. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata për lëndët:* Zhvillimi dhe zbatimi i intervenimeve parandaluese në shkolla (O), Testimi, vlerësimi dhe diagnostikimi në psikologjinë klinike (O), Psikopatologjia e avancuar (O), Çështjet etike dhe profesionale në shëndetin mendor (O) 6+2.
2. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata për lëndët:* Këshillimi grupor (O), Shëndeti mendor në komunitet (Z), Shëndeti mendor online (Digital Mental Health) (Z) 0+5.
3. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata për lëndën:* Gjuhë osmane (Z) 3+0.
4. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata për lëndët:* Zhvillimi Historiografi shqiptare shek. XIX-XX (O), Metodologji dhe teori e shkencës (O), Praktikë institucionale arkivore (O) 6+3
5. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata për lëndët:* Arkitekturë ilire (Z) 2+0.
6. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata për lëndët:* Antropologji e gjinisë (O), Antropologjia e shtetit (O), Antropologji e Evropës Juglindore (O) 6+5.
7. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata për lëndët:* Mirëqenia e fëmijëve (O), Të drejtat e njeriut (O) 6+0.
8. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata për lëndët:* Puna me të rinjtë (O), Aftësi e kufizuar: studime kritike (O) 6+0.
9. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata për lëndët:* Zhvillimi profesional dhe shkrimi i projekteve (Z), Komunikimi profesional (Z), Teori edukimi (Z) 6+0 .
10. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët:* Arkeologji mesdhetare (O) Numizmatikë ilire (Z), Arkeologji mesjetare (O), Arkeologji mesjetare ballkanike (O) 6+2.
11. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët:* Antropologji e gjinisë (O), Antropologjia e shtetit (O), Antropologji vizuale (O), Histori e artit (O), Etnologji shqiptare (O), Histori gojore (O) 8+4.
12. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët:* Hyrje në antropologji (O), Teoritë etnologjike dhe antropologjike (O), Metodat dhe teknikat e hulumtimit (O), Migrimi dhe siguria sociale (O), Struktura dhe organizimi shoqëror (O), Mbrojtja ligjore e trashëgimisë kulturore (O) 8+4.
13. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët:* Hyrje në trashëgimi kulturore (O), Familja dhe farestnia (O), Trashëgimi kulturore (O), Festat dhe festivalet (Z), Politikat dhe praktikat e kujtesës (O), Menaxhimi i trashëgimisë kulturore (O) 6+6.
14. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët:* Të drejtat e njeriut (O), Hyrje në politikat sociale (O), Puna me të rinjtë (O), Socializimi dhe integrimi (Z), Metodat e punës sociale: Puna me raste (O), Bazat e statistikës dhe hulumtimet kuantitative (O), Sjellja njerëzore dhe mjedisi social (Z), Puna sociale në shkollë (O) 10+6.
15. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët:* Mirëqenia e fëmijëve (O), Aftësi e kufizuar: studime kritike (O), Komunikimi profesional (Z), Zhvillimi profesional dhe shkrimi i projekteve (Z), Teori edukimi (Z), Metodat e Punës Sociale: Mediacioni (O), Etika në punë sociale (O) 10+4.
16. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët:* Histori e vjetër shqiptare (O), Histori mesjetare shqiptare (O), Histori botërore mesjetare I (O), Histori e Evropës Juglindore I (O), Histori botërore mesjetare II (O), Histori e Bizantit (O), Digitalizimi i lëndës arkivore (O), Histori e Evropës Juglindore II (O) 8+9.
17. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët:* Histori botërore bashkëkohore I (O), Histori botërore bashkëkohore II (O), Standardet ndërkombëtare të arkivistikës (Z), Rregullimi i lëndës arkivore specifike (Z), Histori publike, menaxhimi i programeve për ruajtjen e historisë (O), Arkivistikë teori dhe praktikë (O), Histori e Evropës Juglindore III (O), Historiografi shqiptare shek. XIX-XX (O) 10+6.

18. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët:* Praktikë institucionale arkivore (O), Restaurimi dhe konservimi i lëndës arkivore (Z), Histori ekonomike e Ballkanit XIX-XX (O), Mbrojtja e trashëgimisë arkivore (Z), Rregullimi dhe përpunimi i lëndës arkivore (Z), Histori e qytetërimeve (O) 7+7.
19. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët:* Hyrje në sociologji (O), Sociologji e sportit (Z), Teoritë klasike të sociologjisë (O), Teoritë bashkëkohore të sociologjisë (O), Sociologji e identitetit (O) 6+6.
20. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët:* Metodatat kuantitative në sociologji (O), Sociologji e religjionit (Z), Lëvizjet shoqërore dhe protesta (O), Metodatat kualitative në sociologji (O), Sociologji politike (O), Shkenca, teknologjia dhe shoqëria (Z), Të drejtat e njeriut dhe drejtësia sociale (Z), Edukimi qytetar dhe demokracia (O) 6+10.
21. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët:* Praktikum i sociologjik (O), Antropologji Sociale (Z), Migrimet dhe diaspora (Z), Sociologji e punës (O), Krimi dhe kontrolli shoqëror (Z), Mendimi social shqiptar (O) 9+4.
22. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët:* Shkrim akademik (O), Teoritë sociale postmoderne (Z) 4+2.
23. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët:* Çështje etike dhe profesionale në shëndetin mendor (O), Zhvillimi dhe zbatimi i intervenimeve parandaluese në shkollë (O), Psikologjia e shëndetit dhe mirëqenies (O), Psikopatologji e avancuar (O), Teoritë bashkëkohore të intervenimit në komunitet (O), Psikologji personaliteti (O), Testimi, vlerësimi dhe diagnostikimi në psikologjinë klinike (O), Praktikum I (Qendra të shëndetit mendor në komunitet) (O), Zhvillimi dhe vlerësimi i programeve (O), Shkathtësi intervistimi (O) 9+5.
24. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët:* Psikologji e përgjithshme (O), Metoda hulumtimi të avancuara (O), Shkrim akademik për psikologji (O), Psikologji zhvillimore (O, Punë sociale), Psikologji sociale (O, Punë sociale) 6+4.
25. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët:* Hyrje në filozofi (O), Filozofi e teknologjisë (O), Histori e filozofisë I – Filozofi antike (O), Filozofia e subjektit (O), Konceptet filozofike të Platonit dhe Aristotelit (O), Autorët e përzgjedhur nga filozofia bashkëkohore (O), Filozofi e arkitekturës (Z) 10 + 4.
26. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët:* Histori e filozofisë II – Empirizmi dhe racionalizmi (O), Histori e filozofisë III, Idealizmi klasik gjerman (O), Filozofi e shkencës dhe metodologji (O), Hyrje në metafizikë dhe ontologji (O), Problemet kryesore të filozofisë moderne (O) 4 + 6.
27. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët:* Arti dhe shoqëria (O), Estetikë (O), Filozofi e të drejtave të njeriut (Z) 4 + 2.
28. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët:* Filozofi e së drejtës (O), Filozofi politike II (O), Debatet mbi globalizmin (Z), Teoritë e demokracisë (Z), Filozofi politike I (O) 6 + 4.
29. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët:* Teoritë e marrëdhënieve ndërkombëtare (O), Të drejtat e njeriut dhe pakicat (Z), E drejta ndërkombëtare publike (O), Administratë publike (O), Analizë e politikës së jashtme (O), Politika në Lindjen e Mesme (O), Gjeopolitika (O) Politikë botërore (O), Kombformimi dhe shtetformimi (O), Studimet e paqes dhe konfliktit (Z), Organizatat ndërkombëtare (O), Kultura politike dhe komunikimi (Z), Çështjet gjinore dhe politika (Z) 10+9.
30. *Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët:* Sistemi politik i Kosovës (O), Mediat dhe politika (O), Qeverisja dhe shteti (Z), Politikat publike (O), Globalizimi dhe integrimet rajonale (Z), Historia botërore bashkëkohore (Z), Politikat e vendeve në zhvillim (Z) Hyrje në politikën krahasimtare (O), Teoritë politike bashkëkohore (O), Qeverisja lokale (Z), Administratë publike krahasuese (O), E drejta dhe politika (Z), Shoqëria civile dhe demokracia (O) 10+8.

## II. FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

1. Një bashkëpunëtor te jashtëm për ligjërata dhe ushtrime për lëndën e gjuhës angleze, gjuhës angleze I dhe gjuhës angleze II në Departamentin e Matematikës.
2. Një bashkëpunëtor te jashtëm për ligjërata dhe ushtrime për lëndën e gjuhës angleze, gjuhës angleze I dhe gjuhës angleze II në Departamentin e Fizikës, Kimisë, Biologjisë dhe Gjeografisë.
3. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata dhe ushtrime për lëndën shkrim akademik.

### (Departamenti i Kimisë)

1. Dy bashkëpunëtor të jashtëm për mbajtjen e ushtrimeve (asistent) për grup lëndësh nga Kimia Organike.
2. Një bashkëpunëtor për mbajtjen e ushtrimeve (asistent) për grup lëndësh nga Kimia Inorganike.
3. Një bashkëpunëtor për mbajtjen e ushtrimeve (asistent) për grup lëndësh nga Kimia Fizike.

### (Departamenti i Matematikës)

1. Dy mësimdhënës për lëndët e shkencës kompjuterike.
2. Gjashtë bashkëpunëtor për mbajtjen e ushtrimeve (asistent) për lëndët e matematikës.
3. Shtatë bashkëpunëtor për mbajtjen e ushtrimeve (asistent) për lëndët e shkencës kompjuterike.
4. Dy bashkëpunëtor për mbajtjen e ushtrimeve (asistent) nga lëndët e ekonomisë.

### (Departamenti i Biologjisë)

1. Një bashkëpunëtor të jashtëm për mbajtjen e ushtrimeve nga lëndët: Fiziologjia e bimëve (Ekologji) sem.III 2+2 për dy grupe 4 orë, Fiziologji e bimëve (Biologji) sem.III 2+2 për tri grupe 6 orë.
2. Një bashkëpunëtor të jashtëm për mbajtjen e ushtrimeve nga lëndët: Biologji e qelizës me histologji (Biologji\_Bch\_O) sem. 12+2 për katër grupe 8 orë, Biologji e përgjithshme (Ekologji\_Bch\_O) sem. 12+2 për 1 grup 2 orë, Biologji e zhvillimit (Biologji\_Bch\_O) sem. II 2+2 për pesë grupe 10 orë.
3. Një bashkëpunëtor të jashtëm për mbajtjen e ushtrimeve nga lëndët: Ekologji e ekosistemeve (Biologji Msc. Sems. I; 2+2; O), Biologjia e konservimit (Ekologji Msc. Sems. II; 2+2; O), Fauna e Kosovës (Biologji Msc. Sems. III; 2+2; Z), Biologjia e llojeve invasive (Biologji Msc. Sems. III; 2+2; Z), Principet e akuakulturës (Biologji Msc. Sems. III; 2+2; Z), Ekologjia e sjelljes së kafshëve (Ekologji Bsc. Sems. III; 2+1; Z), Zooindikatorët (Ekologji Msc. Sems. III; 2+2; Z), Planifikimi hapësinor dhe mjedisi ( Ekologji Bsc. Sems. VI; 2+1; O).
4. Një bashkëpunëtor të jashtëm për mbajtjen e ushtrimeve nga lëndët: Ekofiziologji (O-Ekol.) Msc, Fiziologji e përgjithshme (O- Bio) Bsc, Ekotoksikologji (O-Eko) Msc, Parimet e qëndrueshmërisë mjedisore (Z-Eko) Bsc, Fiziologji e shtazëve (O-Eko) Bsc, Fiziologji e shtazëve (O-BioM) Bsc, Menaxhimi dhe mbrojtja e tokave (Z-Eko) Msc, Përparimi i shtazëve (Z-Bio) Msc, Kaptuj të zgjedhur nga Fiziologjia animale (O-Bio) Msc, Fiziologji krahasuese (O-Bio) Bsc, Hulumtimi në laborator dhe vivarium (Z-Bio) Bsc, Makro dhe mikroanatomia e shtazëve laboratorike (Z-Bio) Msc, Kafshët laboratorike në hulumtime biologjinë molekulare (O-BioM) Bsc, Metodatat hulumtuese të acideve nukleike dhe proteinave (O-BioM) Bsc.

### (Departamenti i Gjeografisë)

1. Një bashkëpunëtor për mbajtjen e ushtrimeve (Asistent) për lëndët e Gjeografisë: Gjeomorfologjia I (O) Bsc, Gjeografia nacionale I (O) Bsc, Klimatologji me meteorologji (O) Bsc, Gjeomorfologjia II (O) Bsc , Gjeomorfologjia aplikative (O) Msc, Gjeografia nacionale II (O) Bsc.



2. Një bashkëpunëtor për mbajtjen e ushtrimeve (Asistent) për lëndët e Gjeografisë: Gjeografia ekonomike (O) Bsc, Pedogjeografia (O) Bsc, Gjeoekonomia (O) Msc, Metodrat dhe analiza e përpunimit të të dhënave gjeografike (O) Msc, Gjeostatistika (O) Bsc, Gjeografia e transportit (Z) Bsc.

### III. FAKULTETI I FILOLOGJISË

1. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët: Fonetikë dhe fonologji e shqipes së sotme (Gjuhë Shqipe, BA), Dialektologji (Gjuhë Shqipe, BA), Morfologji (Letërsi Shqipe, BA), Hyrje në gramatikë teksti të gjuhës shqipe (Gjuhë Shqipe, BA), Sintaksë (Letërsi Shqipe, BA), Sintaksë e gjuhës amtare (Ballkanistikë, BA).
2. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët: Gjuhë shqipe 1 (Orientalistikë, Gjuhë Frënge), Gjuhë shqipe 1 (Gjuhë Angleze, BA), Gjuhë e sotme amtare (shqipe) (Ballkanistikë) dhe Gjuhë shqipe 2 (Gjuhë turke), Norma e gjuhës amtare (Ballkanistikë) dhe Gjuhë shqipe 1 (Gjuhë turke), Gjuhë shqipe 2 (Gjuhë Frënge, Orientalistikë), Leksikologji e gjuhës amtare Ballkanistike (për shqipfolësit), Gjuhë shqipe 2 (Gjuhë Angleze, BA), Gjuhësi e përgjithshme (Ballkanistikë).
3. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët: Norma e shqipes së shkruar (Gjuhë Shqipe, BA), Sintaksë e fjalisë (Gjuhë Shqipe, BA), Sintaksë e periudhës (Gjuhë Shqipe, BA), Norma e shqipes së folur (Gjuhë Shqipe, BA), Leksikologji e gjuhës amtare Ballkanistike (për joshqipfolësit).
4. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët: Psikolinguistikë I (Gjuhë Shqipe, BA), Shqipja e shkruar (Letërsi Shqipe, BA), Psikolinguistikë II (Gjuhë Shqipe, BA), Morfologji I - Sistemi emeror i shqipes (Gjuhë Shqipe, BA), Morfologji II - Sistemi foljor i shqipes (Gjuhë shqipe, BA).
5. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët: Letërsi popullore I (Letërsi shqipe), Bazat e retorikës (Letërsi shqipe), Hyrje në estetikë (Letërsi shqipe), Letërsi shqipe, (Letërsi Shqipe, MA), Kurs monografik (Letërsi shqipe, MA), Letërsi popullore II (Letërsi shqipe), Letërsi për fëmijë (Letërsi shqipe), Kurs monografik I (Letërsi Shqipe), Estetika e letërsisë, (Letërsi shqipe), Format letrare (Letërsi shqipe).
6. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët: Letërsi paramoderne shqipe, Letërsi botërore I, Poezia shqipe, Metodologji e hulumtimit shkencor, Letërsi e krahasuar (MA), Teori letrare (MA), Kurs monografik (MA), Poetika, Letërsi moderne shqipe, Letërsi botërore II, Kritikë letrare, Romani shqiptar.
7. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët: Letërsi e vjetër shqipe I, Letërsia dhe filmi, Përkthimi letrar, Histori e letërsisë shqipe III (Gjuhë Shqipe), Teori e vargut, Letërsi e vjetër shqipe II, Shkrim akademik, Histori e letërsisë shqipe II (Gjuhë Shqipe), Prozë e sotme shqipe, Tregimi bashkëkohor shqiptar, Histori e krahasuar e let. Shqipe (MA), Metodrat e studimit të letërsisë (MA).
8. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët: Frëngjishtja për qëllime specifike, Didaktikë e gjuhës frënge, Mësimdhënia e hershme e gjuhës frënge, Metodikë e gjuhës frënge, Metodologji e hulumtimit shkencor, Glotodidaktikë, Hyrje në hulumtimin shkencor, Metodologji e mësimdhënies së gjuhës frënge, Mësimdhënia e gjuhëve të huaja sipas Kuadrit evropian, Didaktika e gramatikës së gjuhës frënge, Praktika e mësimdhënies së gjuhës frënge, Vlerësimi dhe testimi, Mesimdhënia e letërsisë frënge.
9. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët: Gjuhë Frënge I, Gjuhë frënge III, Morfologji e gjuhës frënge, Sintaksë, Gjuhë Frënge VII, Gjuhë Frënge II, Fonetikë, Morfosintaksë, Leksikologji.
10. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët: Qyteterim islam I, Gjuhë Osmane I, Tekste shqipe me alfabet arab, Qyteterim islam II, Gjuhë Osmane II, Përkthim tekstesh arabe.

11. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët: Morfologji e gjuhës angleze 1, Sintaksë e gjuhës angleze 1, Praktikë profesionale e përkthimit 1, Morfologji e gjuhës angleze 2, Sintaksë e gjuhës angleze 2, Praktikë profesionale e përkthimit 2.
12. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët: Gjuhësi e tekstit, Struktura e gjuhës Angleze (MA), English I (Dep i gjermanishtes), Leksikologji, English II (Dep i gjermanishtes), Pragmatike.
13. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët: Letërsi moderne amerikane, Shekspiri, Stilistika, Pasqyrë e letërsisë amerikane, Letërsi bashkëkohore amerikane, Shkrimi feminist MA (Letërsi angleze).
14. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët: Fonetikë dhe fonologji e gjuhës gjermane, Sintaksë e gjuhës gjermane, Gjuhësi e tekstit, Metodikë e gjuhës gjermane me observim, Morfologji e gjuhës gjermane, Shkrim akademik, Leksikologji dhe fjalëformim, Metodikë me praktikë shkollore.
15. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët: Hyrje në letërsinë gjermane, Letërsi gjermane: Baroku deri te Iluminizmi, Letërsi gjermane: Romantizmi deri te Revolucioni i Marsit, Analizë e teksteve letrare, Letërsi gjermane: Ekspresionizmi deri te Rajhu Tretë, Letërsi gjermane: Mesjeta deri te Humanizmi, Letërsi gjermane: Sturm und Drang dhe Klasika, Letërsia gjermane: Realizmi deri te Simbolizmi, Letërsia gjermane pas 1945.
16. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët: Zhanret e gazetarisë I, Media dhe politika, Zhanret e gazetarisë II, Metoda kërkimi në shkencat sociale.
17. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët: Media dhe e drejta, Radiogazetaria, Editorail, koment analizë, Komunikimi organizativ.
18. Një bashkëpunëtorë i jashtëm për ushtrime për lëndët: Hyrje në teorinë e komunikimit, Metoda kërkimi në shkencat e komunikimit, Teori dhe Praktikë e Marrëdhënieve me Publikun, Gazetari sportive.
19. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët: Bazat e komunikimit masiv I, Bazat e komunikimit masiv II, Opinioni publik.
20. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët: Produksion dhe postproduksion, Çrregullimi informativ dhe pas e vërteta, Komunikimi politik, Gazetari qytetare, Intervista & talkshou.
21. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët: Multikulturalizmi, Marketing dhe advertajzing, Sociologji e komunikimit.
22. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata për lëndën: Diksion.
23. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndën: Diksion.
24. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime (lektor) për lëndët: Morfologji e gjuhës së sotme ballkanike me praktikë gjuhësore (O) (Jo/shqipfoles), Gjuha e sotme ballkanike për nevoja specifike (O) (Jo/shqipfolës), Sintaksë e gjuhës së sotme ballkanike me praktikë gjuhësore (O) (jo/shqipfolës), Varietetet e gjuhës së sotme ballkanike (dialektologji e sociolinguistikë)(O) me praktikë gjuhësore.

#### IV. FAKULTETI JURIDIK

1. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata në lëndën: Historia e Institucioneve Shtetërore dhe Juridike (Semestri I, Ba, O).
2. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata në lëndët e Programit Master në Gjuhën Angleze "*Human Rights, International Criminal Law and Transitional Justice*": Introduction to Transitional Justice (Semestri I, O); Current Affairs in Human Rights, International Criminal Law and Transitional Justice (Semestri I, Z); Introduction to International Criminal Law (*incl. the history of International Criminal Tribunals*) (Semestri II, O); dhe International crimes (*Genocide, Crimes against Humanity and War Crimes*) and jurisdictions (*from Nuremberg to recent trials*) (Semestri II, Z).
3. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata në lëndët e Programit Master në Gjuhën Angleze "*Human Rights, International Criminal Law and Transitional Justice*": Prohibition of



- torture, CPT; OPCAT; NPM (*incl. domestic violence*) (Semestri I, Z); dhe Victims rights (Semestri II, Z).
4. Dy bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për grup lëndësh në Katedrën Penale.
  5. Dy bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për grup lëndësh në Katedrën Civile.
  6. Dy bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për grup lëndësh në Katedrën Kushtetuese Administrative.
  7. Dy bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për grup lëndësh në Katedrën Ndërkombëtare.

## V. FAKULTETI EKONOMIK

1. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata për lëndët: Gjuhë e huaj I Angleze- (Menaxhment, Ekonomiks, - Bachelor Ob), Gjuhë e huaj I Angleze (Banka dhe Financa, Marketing, Bachelor, Ob), Gjuhë e huaj I Angleze- (Kontabilitet- Bachelor, Ob), Gjuhë e huaj Angleze II- (Menaxhment- Bachelor Zgj), Gjuhë e huaj Angleze II (Marketing- Bachelor, Zgj), Gjuhë e huaj Angleze II- (Banka dhe Financa- Bachelor, Zgj).
2. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata për lëndët: Gjuhë e huaj Frënge (Ekonomiks- Bachelor Zgj), Gjuhë e huaj e ndërmjetme Frënge (Ekonomiks- Zgj), Gjuhë e huaj I Frënge- (Marketing, Kontabilitet- Bachelor, Ob), Gjuhë e huaj I Frënge- (Financa- Bachelor, Ob), Gjuhë e huaj II Frënge- (Marketing- Bachelor, Zgj), Gjuhë e huaj Frënge (Ekonomiks- Bachelor, Zgj).
3. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Tregje Financiare (Banka dhe Financa- Bachelor, Ob), Financa Ndërkombëtare (Banka dhe Financa- Bachelor, Ob), Financa Publike (Banka dhe Financa- Bachelor, Ob), Menaxhment Financiar (Banka dhe Financa- Bachelor, Ob), Financat (Banka dhe Financa- Bachelor, Ob), Financat (Kontabilitet- Bachelor, Ob), Teoria e Tregjeve Financiare (Ekonomiks- Bachelor, Zgj).
4. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Banka dhe afarizëm bankar (Banka dhe Financa- Bachelor, Ob), Financat Personale- Bachelor, (Banka dhe Financa- Bachelor, Zgj), Qeverisje Korporative, (Banka dhe Financa- Bachelor, Zgj), Financat Digjetale (Banka dhe Financa- Bachelor, Zgj), Menaxhmenti Bankar (Banka dhe Financa- Bachelor, Ob), Menaxhimi I Portofolios (Banka dhe Financa- Bachelor, Zgj).
5. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Vlerësimi Financiar I Bizneseve (Banka dhe Financa- Bachelor, Zgj), Buxheti (Banka dhe Financa- Bachelor, Ob), Tatimet dhe Strategjia e biznesit (Banka dhe Financa- Bachelor, Ob), Financa të Korporatave (Banka dhe Financa- Bachelor, Ob), Qeverisja financiare (Kontabilitet- Bachelor, Zgj).
6. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Auditimi (Banka dhe Financa- Bachelor, Zgj), Kontabilitet Tatimore (Kontabilitet- Bachelor, Ob), Kontabilisti në Biznes (Kontabilitet- Bachelor, Zgj), Kontabiliteti I Sektorit Publik (Kontabilitet- Bachelor, Ob), Raportim Financiar I (Kontabilitet- Bachelor, Ob), Raportim Financiar II (Kontabilitet- Bachelor, Ob).
7. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Etika profesionale në kontabilitet dhe auditim (Kontabilitet, Ob), Kontabiliteti ndërkombëtar (Kontabilitet, Zgj), SNRF për NVM (Kontabilitet, Zgj), SIK (sistemi informativ i kontabilitetit) (Kontabilitet, Zgj), Auditimi i jashtëm (Kontabilitet, Ob), Kontabiliteti I institucioneve financiare (Kontabilitet, Ob), Kontabiliteti i bankave (Banka dhe financa, Zgj).
8. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Kontabilitet (BF, MXH, MK, EK, KO Bachelor, Ob), Kontabiliteti Financiar (Kontabilitet- Bachelor, Ob), Bazat e Kontabilitetit të Menaxhmentit (Kontabilitet- Bachelor, Ob), Kontabiliteti I Menaxhmentit (Kontabilitet- Bachelor, Ob), Vlerësimi I Bizneseve (Kontabilitet- Bachelor, Zgj).
9. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Financa në biznes (Menaxhment- Bachelor, Ob), Parimet e menaxhmentit (Kontabilitet- Bachelor, Zgj), Ndërmarrësia dhe Menaxhimi I Biznesit të Vogël (Menaxhment- Bachelor, Ob), Ndërmarrësia (Banka dhe Financa- Bachelor, Zgj), Bazat e Menaxhmentit (Menaxhment- Bachelor, Ob), Menaxhimi I operacioneve (Menaxhment- Bachelor, Ob).

10. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Teknologjia informatike e menaxhimit të projektit (Mxh- Bachelor, Ob), Informatika (Menaxhment, Banka dhe Financa, Marketing, - Bachelor, Ob), Menaxhimi I informatave (Menaxhment- Bachelor, Zgj), Analiza e të dhënave në menaxhment dhe ekonomiks (Ekonomiks- Bachelor, Zgj), Hyrje në Metodatat e Hulumentit (Menaxhment- Bachelor, Ob).
11. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Hyrje në biznes (Ekonomiks- Zgj, Marketing- Zgj, Menaxhment, Ob), Ekonomiksi I Migracionit (Ekonomiks, Zgj), Ekonomia e Kosovës dhe BE (Ekonomiks, Zgj), Ekonomia monetare (Banka dhe Financa, Zgj), Integrimi ekonomik evropian (Ekonomiks, Banka dhe Financa, Ob).
12. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Ekonomiksi I zhvillimit (Ekonomiks, Ob), Mikroekonomi I (Banka-O, Menaxhment, Ob), Ekonomiksi I politikave sociale (Ekonomiks, Zgj), Krizat ekonomike (Ekonomiks, Zgj), Makroekonomi I (Menaxhment, Ekonomiks, Ob), Ekonomiksi I ambientit (Ekonomiks, Zgj), Ekonomiksi I dijes (Ekonomiks, Zgj).
13. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: International economics (Applied economics and management (AEM), Ob, Development economics (AEM, Ob), Mikroekonomia- (Marketing- Ob, Kontabilitet- Ob), Economics of the public sector (AEM, Ob, Ekonomiks, O), Indermediate macroeconomics, (AEM, Ob), Macroeconomics (AEM, Ob), Makroekonomi I (Menaxhment, Kontabilitet, Ob).

## VI. FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT

1. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata për lëndët: Organizimi dhe Teknologjia e Ndërtimit-konstruktiv, Ligji i Ndërtimit dhe Rregullativa Ndërtimore Konstruktiv, Rregullativa Ndërtimore Hidroteknike dhe Ekonomia e Ndërtimit K.
2. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata për lëndët: Aplikimi i CAD-it në Gjeodezi, Matje e Tokës, Bazat e Gjeodezisë Inxhinierike, Teknika e matjeve në Gjeodezi, Bazat e të dhënave gjeohapësinore dhe integrimi i të dhënave, Matjet Inxhinierike (përfshihen minierat).
3. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata për lëndët: Gjeologjia e Ndërtimit dhe Gjeologjia Inxhinierike.
4. Një bashkëpunëtor të jashtëm për lektor për lëndët: Gjuhë Angleze (FIN dhe FA).
5. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Konstruksionet prej Druri, Strukturat prej Drurit të Lameluar, Strukturat Murature, Ndërtimi Montazh (FA), Strukturat Inxhinierike (FA), Konstruksionet e Betonit (H), Projektimi i strukturave prej BA, Elementet e parapërgatitura prej BA.
6. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Mbrojtja dhe përforcimi i dherave, Fundimet e Veçanta, Tunelet, Inxhinieria Gjeoteknike, Bazat e Gjeoteknikës, Projektimi i rrugëve K, Projektimi i rrugëve H, gjeologjia Inxhinierike, Inxhinieri Gjeoteknike, Punët tokësorë dhe mekanizim.
7. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Materialet Ndërtimore (H), Teknologjia e Betonit, Materialet Polimere dhe Aplikimet në Inxhinierinë e Ndërtimit, Materialet e ndërtimit (IA), Materialet ndërtimore I (K) dhe Materialet ndërtimore II (K), materialet e ndërtimit (FA).
8. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Teoria e Strukturave I, Teoria e Strukturave II, Analiza Jolineare e Strukturave, Stabiliteti i Strukturave.
9. Katër bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Bazat e gjeoinformatikës, Bazat e të dhënave, Rrjetat gjeodezike, Web Hartografi, Bazat e të dhënave gjeohapësinore dhe integrimi i të dhënave, Sistemet e Navigimit Global Satelitor (GNSS), Rregullimin e tokave, Web GIS, Bazat e të gjeodezisë inxhinierike, Instrumente gjeodezike, teknika e matjeve në gjeodezi, Matje në terren me instrumente gjeodezike, Regjistrimi dhe Vlerësimi i patundshmërive, Hulumentet nga largësitë, Menaxhimi i tokës, Fotogrametria e avancuar digjitale, Matjet Inxhinierike dhe Vrojtimi i tokës.

10. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Metodatat e barazimeve, Hartografi Topografike, Përdorimi i Gjeoinformacioneve, hartografi, Bazat e GIS-it, Hartografi Matematikë dhe Skenimi laserik tredimensional në gjeodezi, Gjeoinformatikë, Gjeovizualizimi, Teoria e Avansuar e gabimeve, Shkenca e gjeoinformacionit dhe Analiza Hapësinore, Modelimi virtual kartografik, Gjeodezia fizike dhe tektonika, Aplikimi i GIS në menaxhimin e ujërave dhe teknika e matjeve në gjeodezi H.
11. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Menaxhimi i Ujërave, Mekanika e Fluideve (H), Mekanika e Fluideve (IA), Inxhinieria e Kullimit, Dinamika e Ujërave Nëntokësore, Menaxhimi i Resurseve Ujore, Modelimet Hidraulike, Introduction: IWRM and Water Security, Inxhinieria e Lumenjëve, Rregullimi i lumenjëve, Sistemet e ujitjes.

## VII. FAKULTETI I ARKITEKTURËS

1. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata për lëndët: Teknikat e Urbanizmit (Arkitekturë, BSc, Z); Urbanizimi 1 (Arkitekturë, BSc, O); dhe Urbanizimi 2 (Arkitekturë, BSc, O).
2. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata për lëndët: Projektim 8 (Arkitekturë, MSc-i, O); STUDIO - Shoqërore (Arkitekturë, MSc-i, O); dhe Projektim STUDIO - Objektet Shëndetësore (Arkitekturë, MSc-i, Z).
3. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Arkitektura dhe Gjeometria (Arkitekturë, BSc, O); Vizatimi i Lirë dhe Estetika e Hapësirës (Arkitekturë, BSc, O); Reprerentim Arkitektonik (Arkitekturë, BSc, O); BIM (Arkitekturë, MSc, O); Laboratori i Dizajnit Kompjuterik (Arkitekturë, MSc, O); Aspekti Vizual i Performancës së Ndërtesave (Arkitekturë, MSc, Z); GIS në planifikim Hapësinor (Arkitekturë, MSc, Z); Modelimi dhe Simulimi i Energjisë në Ndërtesa (EE, MSc, O), Modelimi 3D i Ndërtesës (EE, MSc, Z); Zhvillimi i Dizajnit Parametrik në Arkitekturë (Arkitekturë, MSc, O); Softuerët dhe Web-mobil Aplikacionet (Arkitekturë, MSc, O); Gjeometri Deskriptive (Fakulteti i Inxhierisë së Ndërtimit, BSc, O); dhe Gjeometri Deskriptive (Fakulteti i Inxhierisë së Ndërtimit, BSc, O).
4. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Fizika e Ndërtimit (Arkitekturë, BSc, O); Struktura Hapësinore (Arkitekturë, BSc, Z); Mbështjellësi i Objektit dhe Fasada (Arkitekturë, MSc, O); Metodologjia e Hulumtimit në Arkitekturë (Arkitekturë, MSc, O); STUDIO - Arkitektura e Qëndrueshme (Arkitekturë, MSc, O); Fizika e Ndërtimit dhe Performanca e Energjisë (EE, MSc, O); Mbështjellësi i Qëndrueshëm i Ndërtesës (EE, MSc, Z); dhe Konstruksionet Ndërtimore (Fakulteti i Inxhierisë së Ndërtimit, BSc, O).
5. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Bazat e Projektimit I (Arkitekturë, BSc, O); Projektimi 2 - Objektet Shumëbanesore (Arkitekturë, BSc, O); Projektimi 3 - Banimi i Përkohshëm (Arkitekturë, BSc, O); dhe STUDIO - Banim (Arkitekturë, MSc-i, O).
